



Republika e Kosovës-Republic of Kosovo  
Komuna-Municipality  
Hani i Elezit



04/1717 /2025

# DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

## RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN SHKURT 2025

Hani i Elezit, 2025

## DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin Shkurt 2025, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit Shkurt 2025 kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me **NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025** është në lartësi prej **3,615,457.00 Euro.**

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa..... 2,188,542.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 584,500.00 €,
- Shpenzimet komunale .....94,000.00 €,
- Subvencione dhe transfere ...143,000.00 €,
- Shpenzime kapitale ..... 605,415.00 €,
- Totali i buxhetit..... 3,615,457.00 €.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

### SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale për muajin Janar 2025,
- Barazimi me Thesar për muajin janar 2025,
- Korrigjimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2024 dhe anekset përcjellëse si dhe dorëzimi i tyre në Departamentin e Thesarit – MFPT,
- Është dërguar për publikim borxhi publik i muajit janar 2025 në ueb faqen komunale,
- Kemi lidhur një Memorandum Mirëkuptimi me DEMOS lidhur me përmirësimin e proceseve buxhetore,
- Është përgatitur Plani i Cash-it për çdo Nën-Program buxhetor për vitin 2025,
- Përgatitja dhe publikimi i raportit të punëve dhe aktiviteteve të muajit dhjetor 2024,
- Përgatitja dhe publikimi i raportit të punëve dhe aktiviteteve për vitin 2024 në dy formate: Word dhe PDF,
- Ka filluar auditimi nga Zyra Kombëtare e Auditimit,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

### RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN SHKURT 2025

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Buxheti 2025	Realizimi shkurt 2025	% Realizim/planifikim
Paga dhe shtesa	2,188,542.00	186,481.29	8.5%
Mallra dhe shërbime	584,500.00	10,400.00	1.7%
Shpenzime komunale	94,000.00	0	0%
Subvencione dhe trans.	143,000.00	0	0%
Shpenzime kapitale	605,415.00	0	0%
<b>TOTAL</b>	<b>3,615,457.00</b>	<b>196,881.29</b>	<b>5.4%</b>

## SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2025 është në shumë prej 339,719.00 €. Inkasimi i të hyrave për muajin janar dhe shkurt janë në shumë prej 21,509.31 € dhe paraqesin 6.3%.

- Kemi pranuar Projektionin e THV për vitet 2026-2028, e kemi bërë projektionin e të gjithë llojeve të të hyrave për vitet përkatëse dhe e kemi dorëzuar në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
- Regjistrimi, harmonizimi i të hyrave ditore në SIMFK.

## SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka kryer shërbime të rregullta ndaj qytetarëve, siç janë: lëshimin e faturave të tatimit në pronë, lëshimin e vërtetimeve për qëllime të ndryshme.

Në Kuvend Komunal gjatë muajit shkurt, e kemi propozuar Plotësim-Ndryshimin e Vendimit mbi caktimin e normave tatimore i marrë në vitin 2024, pasi që kemi pasur një rekomandim nga Departamenti i Tatimit në pronë, për ndryshimin e preambulës së atij vendimi për arsye se pasi është miratuar në Kuvend Komunal, është plotësuar/ndryshuar/shfuqizuar një pjesë e bazës ligjore të vendimit.

Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

*L. Ballazhi*

